



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:111151
Datë: 05.03.2024
Numri i dokumentit: 05413681

2019:111152

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Dega Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari individual Burhan Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditëses I. Ç. nga fshati ..., Komuna Kaçaniku, kundër të paditurës ...- Bank Prishtine, e përfaqësuar me autorizim nga D. L. R. L.L.C, me seli në Prishtinë dhe te paditurit B. Ç. nga fshati ..., komuna Kaçanik, në çështjen kontestuese anulimi i kontratës së hipotekës dhe njohjen e së drejtës së pronësisë mbi bazën e kontributit, në seancën e shqyrtimit përgatitor, me dt. 14.02.2024, merr ndërsa me datë 05.03.2024, përpilo me shkrim, këtë:

A K T V E N D I M

I. Padia e paditëses I. Ç. nga fshati ..., Komuna Kaçaniku, e datës 13.05.2019, e ushtruar ndaj të paditurës ...- Bank Prishtine, e përfaqësuar me autorizim nga D. L. R. L.L.C, me seli në Prishtinë dhe te paditurit B. Ç. nga fshati ..., komuna Kaçanik, në çështjen kontestuese anulimi i kontratës së hipotekës dhe njohjen e së drejtës së pronësisë mbi bazën e kontributit, KONSIDEROHET e TËRHEQUR.

II. Secila palë i përballon shpenzimet e krijuara.

A r s y e t i m

Paditësja I. Ç. nga fshati ..., Komuna Kaçaniku, ka ushtruar padi në këtë gjykatë me dt. 13.05.2019, lidhur me çështjen kontestuese, anulimi i kontratës së hipotekës dhe njohjen e së drejtës së pronësisë mbi bazën e kontributit, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadija e paditëses dhe të anulohet kontrata e hipotekës e lidhur ndërmjet te paditurës ...-Prishtina sh. a. me seli në Prishtinë dhe B. Ç. dhe pas anulimit të kontratës të bëhet njohja e së drejtës së pronësisë mbi bazën e kontributit bashkëshortorë..

Gjykata ka ndërmarr veprime përgatitore duke dërguar padinë dhe aktvendimin për përgjigje në padi palëve të paditura, e në rastin konkret e paditura e parë ...-Prishtina në përgjigjen me shkrim kanë deklaruar se e kundërshtojnë padinë dhe kërkesë padinë e paditëses si të pa bazuar, duke theksuar se e paditura tani më nuk është pronare e kësaj prone sepse me datë 10.01.2024, është themeluar kontrata e shitblerjes te noteri, ku si blerës është i padituri i dytë B. Ç., që nënkupton se kjo pronë i është kthyer prapë debitorit dhe kjo tregon se padia është tërësisht e pakuptimtë.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore me datën 14.02.2024, në të cilën prezent kanë qenë përfaqësuesi me autorizim për të paditurën e pare, Q. I., ndërsa pala paditëse nuk ka qenë prezentë edhe pse e ftuar me rregull, ky fakt i konstatuar nga gjykata në bazë të fletë dërgesës për dorëzim personal, të cilën pala paditëse e ka pranuar personalisht me datë 25.01.2024, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe nuk ka kërkuar shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor. Gjithashtu nuk ka qene prezent edhe i padituri i dyte B. Ç., i ftuar ne mënyre te rregullt nga gjykata, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe nuk ka kërkuar shtyrjen e seancës se shqyrtimit gjyqësor, andaj gjykata konform nenit 409 par.1 të LPK-së padinë e paditëses e konsideroi të tërhequr.

Gjykata e vendosi që secila palë ti përballoj shpenzimet e krijuara ndërsa konstatoi se pala paditëse e ka paguar taksën prej 30€, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore UA.01/2017 neni 12.1, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata në kuptim të dispozitave të nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

Numri i lëndës: 2019:111151
Datë: 05.03.2024
Numri i dokumentit: 05413681

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega Kaçanik

Departamenti i Përgjithshëm

2019:111152, dt. 05.03.2024

Gjyqtari:

Burhan BERISHA

KËSHILLË JURDIKE:

Kundër këtij aktvendimi

nuk është e lejuar ankesa